

VENDIM
Nr. 994, datë 8.11.2013

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 658, DATË 7.8.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
DHE RIPËRTËRITJEN E FUQISË LIGJORE TË DISA PIKAVE TË VENDIMIT NR. 771,
DATË 7.11.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR
PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PERSONELIT DHE KAPACITETEVE TË NJËSISË SË
SHËRBIMIT NË QENDRAT SPITALORE UNIVERSITARE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 123, 125 e 127 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe të pikës 5 të nenit 12 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 658, datë 7.8.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kriterëve për përcaktimin e numrit të personelit dhe kapaciteteve të njësisë së shërbimit në qendrat spitalore universitare”.
2. Ripërtëritjen e fuqisë ligjore të pikave 1, 2 dhe 3 të vendimit nr. 771, datë 7.11.2012 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kriterëve për përcaktimin e numrit të personelit dhe kapaciteteve të njësisë së shërbimit në qendrat spitalore universitare”.
3. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë të ndjekë procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama